



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Mandate, Imunitete e Rregullore të Kuvendit

Mbledhja nr. 28

Prishtinë, me 30 qershor 2010, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Mandate, Imunitete e Rregullore të Kuvendit

Në mbledhje morën pjesë: Hydajet Hyseni - Kaloshi, Kolë Berisha, Dzezair Murati Ramadan Gashi, Fatmire Berisha, Ahmet Isufi, Besa Gaxherri dhe Vladimir Todorovic.

Mungoi: Suzan Novobrdaliu.

Pjesëmarrës të tjerë: Floriana Shala – OSBE, Rinor Beka-NDI, Liridon Selmani - KDI.

Nga Divizioni për mbështetje komisioneve parlamentare: Manush Krasniqi

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni - Kaloshi - kryetar i Komisionit.

RENDI I DITËS

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 21.06.2010;**
- 3. Miratimi i rekomandimit për Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kuvendit;**
- 4. Çështjet vijuese.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 21.06.2010;

Procesverbali nga mbledhja e datës 21 qershor 2010 u miratua pa vërejtje.

3. Miratimi i rekomandimit për Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kuvendit;

Kryetari, e paraqiti rekomandimin e Komisionit për Kryesinë e Kuvendit, ku përfshihej çështja e betimit të deputetëve dhe çështja e parashtrimt të pyetjeve parlamentare. Po ashtu propozoj që dokumenti të quhet Propozim dhe jo Rekomandim për shkak se po parashtrohen disa propozime dhe po i lihet mundësia Kryesisë që të vendos.

Dzezair Murati duke u ndërlidhur me parafolesin, përkrah propozimin e betimit të deputetëve të rinjë, po ashtu shprehu brengjen për mosnjohimin në seancë plenare të deputetëve të rinjë, nuk e dimë se kush janë ata, apo në vend të kujt kanë ardhur. Po ashtu ngriti shqetësimin e mungesës së deputetëve në seancat plenare.

Besa Gaxherri tha se ne jemi kompetent të gjejmë një mundësi për rregullimin e këtyre çështjeve siç është betimi i deputetëve dhe çështja e pyetjeve parlamentare. Sanksionimi i vetëm për mungesën e deputetëve është ai politik, nuk ka mundësi ligjore për sanksionimin e deputetëve për mungesat e tyre në seancat plenare. Sa i përket pyetjeve parlamentare përkrah propozimin se mund të zhvendosen, propozon që pyetjet të shtrohen pas pauzës, nuk e përkrah propozimin që ato të shtrohen në fund të seancës, pasi nuk do të jenë prezent deputetët dhe kabineti qeveritar, ndërsa që të organizohet një seancë e veçantë për pyetjet parlamentare është shprehur se nuk do të kishte sukses. Po ashtu ngriti çështjen e ndryshimit të ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit lidhur me angazhimet e deputetëve, të jenë të përqendruar në punën në Kuvend dhe të mos punojnë në edhe në vende të tjera. Propozoj që këto propozime të diskutohen në një rreth më të gjerë.

Ahmet Isufi përkrah propozimin që të mbahet seancë e veçantë për pyetjet parlamentare, por të caktohet edhe afati kohor p.sh.: 2 deri në 3 orë, nuk pajtohet me propozimin që pyetjet të mbahen në fund të seancës për shkak të mos prezencës së kabinetit qeveritar. Përkrah propozimin që pyetjet parlamentare të shtrohen pas pauzës dhe shtoj që të koordinohet koha me Qeverinë që të sigurohet prezenca e kabinetit qeveritar në seancën plenare gjatë shtrimit të pyetjeve parlamentare. Kjo çështje do duhej të diskutohet edhe në Kryesinë e Kuvendit bashkë me shefat e Grupeve Parlamentare.

Kryetari - Pjesëmarrja e deputetëve në Kuvendin tonë është më e larta në krahasim me vendet tjera. Sa i përket çështjeve jashtë rendit të ditës, në Bundestagun gjerman kërkohet të njoftohet Kryetari 6 apo 7 orë më herët, që ai të jetë i njoftuar me çështjen. Çështja e pranisë së ministrave në mbledhjet e komisioneve me Rregulloren e re është përmirësuar, shtrohet çështja se sa do të zbatohet. Kemi kërkuar që ligji të mos shqyrtohet në Komision pa praninë e Ministrit. T'i propozohet Kryesisë që pyetjet parlamentare të mos hiqen nga rendi i ditës edhe në mungesë të Ministrit, të përsëriten deri sa të marrin përgjigje. Këto që kemi propozuar ne janë një zgjidhje e mire, por këtë çështje nuk e vendosim ne, për këtë vendos Kryesia.

Kryetari pas diskutimeve konstatoi se Komisioni, nxori këto propozime:

PROPOZIME

1. Në pajtim me nenin 10 të Rregullores, deputetet e certifikuar ndërkohë të bëjnë betimin, i cili, sipas Rregullores është i obligueshëm për të gjithë deputetët. Kryetari i Kuvendit respektivisht kryesuesi i seancës, njofton Kuvendin dhe opinionin për pushimin e mandatit të deputetëve të zëvendësuar, shpall emrat e deputetëve të rinj dhe i fton ata të bëjnë betimin, sipas procedurës së paraparë me Rregullore.
2. Në funksion të rezervimit të kohës së përshtatshme për procesin e ligjvënies, të shqyrtohet mundësia e zhvendosjes së Pyetjeve parlamentare, të paraparë në nenin 45 të Rregullores së Kuvendit, në njërën nga këto terminët më të përshtatshme:
 - pas pushimit të drekës;
 - në fund të mbledhjes plenare;
 - në mbledhje të veçantë (mujore ose dyjavore) të pyetjeve parlamentare.

4. Çështjet vijuese

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit së në bashkëpunim me NDI-në janë në vigjilje të organizimit të një punëtorie lidhur me deklaratat e deputetëve dhe të grupeve parlamentare për çështjet që nuk janë në rend të ditës, betimit të deputeteve dhe pyetjeve parlamentare, ku do të ftohen anëtarët e Kryesisë, shefat e grupeve parlamentare dhe ekspertë të ndryshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E hartoi:

Njësia për mbështetje të Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Hydajet HYSENI - KALOSHI